



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 18 datë 25.3.2021

**PËR VAZHDIMIN E FINANCIMIT TË DISIPLINAVE SPORTIVE SIPAS PBA 2021-2023,
PROGRAMI “SPORT DHE ARGËTIM”, PËRMES METODOLOGJINË LOD, PAS
MBYLLJES SË FUNKSIONIMIT TË KLUBIT SPORTIV “VLLAZNIA”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 25.3.2021, zhvilluar online, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, neni 25, pika 4 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; nenit 21 të ligjit 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; VKB nr. 63, datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2021 - 2023 të Bashkisë së Shkodrës”, VKB nr. 69, datë 30.10.2017 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile“, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë mbylljen e institucionit të varësisë “Klubi Sportiv “Vllaznia” më datën 30.06.2021.
2. Të miratojë vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, Programi “Sport dhe Argëtim”, përmes Metodologjinë LOD.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 26.3.2021